

## 5. Xhamia është vend për takime dhe diskutime

Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, zakonisht i ka mbledhur Sahabët në xhami për të diskutuar për çështje të rëndësishme (për lufta, marrëveshje, kriza, etj.) dhe kanë marrë vendime të caktuara për to. Xhamia poashtu ka qenë vend mbledhjeje për ushtarët e Armatës Islame, nga e cila ata janë nisur për në luftë dhe në të cilën ata janë kthyer nga lufta.

## 6. Xhamia është vend për kujdes mjeksor

Para zhvillimit të spitaleve nga civilizimi Islam, rreth dy shekuj më vonë, xhamia e Muhammedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka qenë vend për kujdes të të plagosurve të në lufta dhe në kriza të ngjashme.

## 7. Xhamia është vend për arsim

Ata që nuk dinin të shkruajnë dhe të lexojnë, atë e kanë mësuar në xhaminë e Muhammedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Muslimanët e kanë zhvilluar gjithë civilizimin Islam në bazë të arsimit që e kanë marrë nëpër xhami.

Aktiviteti i vetëm që është ndaluar të zhvillohet në xhami - përveç akteve të ndaluara dhe të pamoralshme - ka qenë shitja dhe blerja e gjërave të caktuara. Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka theksuar që xhamitë nuk duhet të përdoren për përfitim material. Ndryshe, ekzistojnë shumë argumente që tregojnë se xhamia e Muhammedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ishte thjesht "një vend i shoqërisë" që ka qenë e mbushur përplot me aktivitete të ndryshme.

*Jasser Auda*


*Përgatiti: Klubi Studentor*

**Pasi të lexoni këtë broshurë, mundësojani të tjerëve të lexojnë të njëjtën.**

**Dhe keni kujdes, fletushka përmban ajete kur'anore, andaj ndalohet hyrja me të në vende të ndotura, gjegjësisht në toalet si dhe në vende të ngjashme.**



# Roli i xhamive në Islam





Në Islam, xhamitë nuk janë vetëm vende për t'u falur. Sipas terminologjisë moderne, xhamitë janë qendra shoqërore. Roli i xhamive në Islam është një nga gjërat kryesore që duhet të reformohen para se ummeti musliman të del nga gjendja aktuale.

Mirëpo, si e dinë dhe si e vlerësojnë muslimanët rolin e vërtetë të xhamisë? Përgjigja është e thjeshtë: duke iu referuar Sunnetit të Muhammedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem. Një hulumtim i shpejtë shpalos rolet që xhamia e Muhammedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, i ka pasur gjatë jetës së tij.

## 1. Xhamia është vend për t'u falur

Xhamia e Muhammedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka qenë vendi kryesor për besimtarët, ku ata janë mbledhur dhe kanë falur namaz pesë herë në ditë. Për fat të keq, në këtë kohë, ky është roli i vetëm që xhamia është duke e luajtur (në jetën tonë.)

Xhamia e Muhammedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka qenë e hapur për secilin, për burrat dhe gratë, pleqët dhe të rinjtë, arabët dhe jo-arabët. Këtë e dëshmojnë një numër i Haditheve të transmetuar nga Buhariu dhe Muslimi në kaptinat që i referohen xhamive. Në këtë kohë, nëpër xhami, ekzistojnë disa mangësi:

**a)** Në përgjithësi grate nuk lejohen në pjesën më të madhe të xhamive dhe se vendi ku gratë bëjnë namaz, nëse ai ekziston, është më i zbrazët se vendi i burrave. Xhamia e Muhammedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka qenë ndryshe. Në të ka pasur një vend për secilin. Gratë janë falur prapa burrave në rendet e tyre, dhe e gjithë ajo ka qenë e qartë: Islami nuk lejon kontakt fizik ndërmjet gruas dhe burrit gjatë namazit (lutjes Allahut, sub-hanehu ve te'ala). Lutja ose namazi rreth qabes është përjashtim nga kjo rregull për shkak të kufizimeve hapësinore. Ndalimi i hyrjes së grave nëpër xhami ka ndodhur rreth dy dekada pas vdekjes së Muhammedit,

sal-lallahu alejhi ve sel-lem, pavarësisht nga kundërshtimi i disa Sahabëve që e kanë transmetuar këtë hadith: *"Mos i ndaloni shërbyeset e Allahut t'i vizitojnë shtëpitë e Allahut (xhamitë)"*

**b)** Vërrejmë, sidomos në vendet perëndimore, se në të njëjtën lagje ka xhami të arabëve, xhami të indianëve, xhami të turqëve, pakistanezëve, afrikanëve, etj. E gjithë kjo është jo-Islame. Sahabët e Muhammedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ishin nga çdo prejardhje dhe racë, e të gjithë ata janë falur së bashku.

**c)** Poashtu shohim se disa njerëz, nëpër disa xhami, nuk i lejojnë fëmijët të hyjnë në xhami dhe i largojnë ata nga xhamitë. Edhe kjo është në kundërshtim me Sunnetin e Muhammedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem.

## 2. Xhamia është vend për shoqërim

Xhemati lidhet në xhami. Transmetohet se Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka pyetur për ndonjë nga shoëruesit e tij (mashkull ose femër) të cilin ai nuk e kishte parë për një ose dy ditë, të shkojë dikush t'i ndihmojë nëse ka pasur nevojë për ndihmë ose t'i vizitojnë nëse kanë qenë të sëmurë.

## 3. Xhamia është vend për thirrje në Islam

Ekzistojnë disa Hadithe të vërteta që tregojnë se xhamia e Muhammedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka qenë një vend i zakonshëm për ata që kanë dëshiruar të pyesin për Islamin, interesohen për të, të vijnë në xhami dhe të pyesin. Jo-muslimanët nuk janë larguar nga xhamia, gjë që, për fat të keq, ne e shohim nëpër xhami në këtë kohë.

## 4. Xhamia është vend për festime

Muhammedi, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, ka këshilluar Sahabët që "të njoftojnë për ceremonitë martesore, ti mbajnë ato nëpër xhami, dhe ato njoftime t'i bëjnë duke u rënë lodrave (tupanave)" dhe se xhamia është vendi për to. Siç transmeton gruaja e Muhammedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem, Aisha r.a., Dita e Bajramit poashtu ka qenë ditë feste kur "etiopianët kanë luajtur me shtiza në xhami". Ajo poashtu ka thënë se kur ata kanë luajtur në xhami, ajo i ka shikuar ata pranë Muhammedit, sal-lallahu alejhi ve sel-lem.